



# Strategjia dhe Plani i Punës

HandiKOS,  
Shoqata e paraplegjikëve  
dhe paralizës së fëmijëve  
të Kosovës

PRISHTINË  
2013

2014 – 2016

## FALENDERIM

Hartimi i strategjisë dhe planit të punës 2014-2016 i HandiKOS, shoqatës së paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës, është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të vet personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre, personelit dhe bordit të organizatës sonë. Të gjithë këta përmes sygjërimeve dhe rekomandimeve të tyre kanë kontribuar që strategjia të përfshij plotësisht nevojat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë në plotësimin e të drejtave për qasje të lirë, shërbime cilësore shëndetësore, shërbime sociale sipas nevojave, arsimim dhe punësim.

Kontribut të vecantë në zhvillimin e strategjisë ka dhënë Roberto Cancel i cili me profesionalizmin dhe punën e tij të palodhshme ka ndjekur dhe lehtësuar hap pas hapi të gjithë procesin e hartimit të kësaj strategjisë.

HandiKOS falenderon të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare për mbështetjen e vazhdueshme dhënë organizatës dhe personave me aftësi të kufizuara. Në veçanti, HandiKOS, falenderon Ambasadën e Finlandës në Prishtinë e cila me përkrahjen e saj shumëvjeçare ka bërë që të arrihen pjesa më e madhe e rezultateve të punës së organizatës sonë në të mirë të personave me aftësi të kufizuara.

Këtë vit shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës- HandiKOS, shënon 30 vjetorin e themelimit të saj me ç'rast u shpreh mirënjohje të gjithë atyre që gjatë gjithë këtyre viteve kanë dhënë kontributin e tyre në mbështetjen e shoqatës sonë dhe personave me aftësi të kufizuara, në veçanti falenderon të gjithë vullnetarët e angazhuar gjatë viteve të '90.

Afrim Maliqi  
Drejtor i HandiKOS-it  
Tetor, 2013

## Përmbajtje

Përmbledhje ekzekutive _____	3
Historiku i HandiKOS _____	4
Analiza e situatës _____	8
Analiza SWOT (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet) ____	11
Analiza e akterëve _____	13
Misioni i HandiKOS _____	14
Vizioni i HandiKOS _____	14
Realizimi i objektivave strategjike _____	15
Plani i Punës _____	17
Resurset e nevojshme _____	22

### Përmbledhje ekzekutive

Pas një procesi konsultimesh me anëtarët, bordin, stafin, bashkëpunëtorët dhe palët e interesuara, HandiKOS, duke u bazuar në të drejtat, nevojat dhe gjendjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe duke pasur parasysh situatën aktuale socio-ekonomike në vend, ka hartuar strategjinë e re dhe Planin e Punës të cilat do të jetë bazë e punës së HandiKOS-it për periudhën 2014-2016. Gjatë kësaj periudhe, HandiKOS do të punoj drejt arritjes së një shoqërie gjithëpërfshirëse me njohje dhe respektim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara. Strategjia e hartuar dhe përgatitur me pjesëmarrjen aktive të palëve të lartpërmendura si dhe Planin e Punës janë aprovuar nga Bordi i HandiKOS-it dhe do të shërbejnë në arritjen e objektivave gjatë kësaj periudhe.

HandiKOS është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1983, përfaqëson dhe përkrah personat me aftësi të kufizuara duke avokuar dhe lobuar për të drejtat dhe duke ofruar shërbime përmes rrjetit me 14 qendrave dhe 13 zyrave lokale të vendosura në gjithë Kosovën, me qëllim të përmbushjes së nevojave, për të arritur të drejta të barabarta, jetë të pavarur dhe të dinjitetëshme drejt pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Gjatë periudhës 2014 – 2016 HandiKOS do të punoj drejt arritjes së një shoqërie gjithëpërfshirëse me njohje dhe respektim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara. Për të arritur këtë HandiKOS ka vendosur dy objektiva kryesore: (1) Zhvillimi dhe avancimi i shërbimeve sociale të vetë qëndrueshme të bazuara në bashkësi për persona me aftësi të kufizuara, dhe (2) Avancimi i të drejtës për lëvizje të lirë, shërbime cilësore shëndetësore, mirëqenie sociale, arsim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara.

## Historiku i HandiKOS

“Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është themeluar në vitin 1983, me iniciativën e Z. Halit Ferizi, kryetar i atëhershëm i shoqatës dhe më vonë lider i lëvizjes së aftësisë së kufizuar në Kosovë, së bashku me një grup të qytetarëve me aftësi të kufizuara. Objektivë kryesore e kësaj Shoqate ishte “përmirësimi i të drejtave dhe i standardeve të jetesës së personave me aftësi të kufizuar në Kosovë” përmes veprimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe të punësimit.

Që nga viti 1989, gjendja e personave me aftësi të kufizuar u keqësua me të shpejtë, gjendje të cilën e ndihmoi kriza në kontekstin politik, social dhe ekonomik. Shkatërrimi i sistemit të kujdesit shëndetësor, humbja e vendeve të punës më së shumti preku këtë grup njerëzish të cilët edhe ashtu ishin plotësisht të varur nga burimet e pakta të familjes. Një pjesë e madhe e personave me aftësi të kufizuar jetonin me pak apo pa fare ndihmë nga shërbimet e mbrojtjes sociale, ngaqë me largimin e mbajtësve të familjes nga vendet e punës humbnin edhe ato pak të drejta që kishin gëzuar deri atëherë. Kjo gjë i bëri ata plotësisht të varur nga ndihma humanitare. Situata e këtillë shtyri shoqatën që të ndërmarrë aksione me qëllim të zbutjes së situatës së Personave me Aftësi të Kufizuara duke lobuar dhe avokuar tek institucionet e sistemit paralel për të inkorporuar nevojat e Personave me Aftësi të Kufizuara në lëvizjen e gjithmbarshme popullore.

Programi i rehabilitimit të bazuar në bashkësi (RBB) filloi në gjysmën e parë të vitit 1994. Gjatë këtij viti shoqata me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të Handicap International (HI) e cila paraqet edhe kontaktin e parë të shoqatës me një organizatë ndërkombëtare, ku u siguruan materiale si: karroca dhe material higjienik për 200 familje. Ky program më tej vazhdoi të realizohet në bashkëpunim dhe bashkëveprim me HI dhe me organizata të tjera ndërkombëtare dhe lokale si:

- HANDICAP INTERNATIONAL (HI), organizatë ndërkombëtare, përmes përkrahjes me kuadër nga jashtë (fizioterapeutit dhe psikologut) dhe ofrimit të pajisjeve ndihmëse, material për inkontinencë dhe material mjekësor për trajtimin e plagëve dekubitare, si dhe mjete për rehabilitimin psiko-social dhe primar fizikal të fëmijëve.
- NËNA TEREZË, shoqatë lokale humanitare/bamirëse, përmes kontributit të drejtpërdrejtë të mjekëve dhe infermierëve vullnetarë të kësaj shoqate.

## Historiku i HandiKOS

•OXFAM-i, organizatë nga Britania e Madhe, përmes trajnimeve mbi të drejtat dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri si dhe ndihmave në veshmbathje, mjete higjienike, etj.

•Organizata dhe agjenci të tjera si Save the Children, Mercy Corps, Children Aid Direct etj, përmes sigurimit të pakove higjienike për rastet sociale dhe personave me aftësi të kufizuara që jetonin në kushte të vështira.

Gjatë kësaj kohe mbi 320 aktivistë të profileve të ndryshme përfshirë këtu edhe vet personat me aftësi të kufizuara u përfshinë në identifikimin, vlerësimin dhe përkrahjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Ky grup aktivistësh paraqiste një bazë të mirë për krijimin e strukturave të para organizative të emëtuara grupe aktive lokale (GAL).

Programi u organizua në fazat si më poshtë:

- Themelimi i grupeve aktive lokale;
- Furnizimi me pajisje të duhura për përmirësimin e jetës sociale;
- Shpërndarjen e drejtpërdrejtë në familje dhe edukimi rreth përdorimit dhe mirëmbajtjes së materialit;
- Vizitat përcjellëse, të realizuara nga zyrtarë lokale dhe ekipi i rehabilitimit (shërbimeve) të bazuar në bashkësi i nivelit qendror;
- Parandalimi i pasojave të aftësisë së kufizuara;
- Themelimi i qendrave të rehabilitimit të bazuar në bashkësi (QRBB).

Menjëherë pas luftës, HandiKOS përsëri filloi një organizim të ri duke u përpjekur që ta riaktivizonte rrjetin dhe të caktoje objektivat kryesore të veprimit në bashkëpunim me agjencitë ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare (OJQ) vendore me qëllim të përkrahjes së personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre me material dhe mjete të domosdoshme për jetë.

Prezenca e organizatave ndërkombëtare i ofroi HandiKOS-it mundësinë që të bëjë shumë shpejt rikonstruktimin e rrjetit dhe jo vetëm që rriti numrin e grupeve aktive lokale dhe të qendrave të bashkësisë por me ndihmën e përkrahjes nga jashtë i punësoi shumë nga vullnetarët. Në periudhën e emergjencës, për ti përbushur nevojat e qytetarëve me aftësi të kufizuara është bërë regjistrimi i personave me aftësisë së kufizuara dhe shpërndarja e materialit higjienik, mjekësor dhe pajisjeve ndihmëse. Për çdo grup aktiv lokal ishin të nevojshëm tre punëtorë ku dy prej tyre ishin punëtorë të terrenit dhe një përgjegjës i zyrës.

## Historiku i HandiKOS

Në çdo qendër të bashkësisë ishin: koordinatori, dy punëtorë të rehabilitimit primar fizikal, një për aktivitetet psike-motorike dhe një vozitës për transportimin e fëmijëve.

Puna e qendrave të HandiKOS-it përcillej nga fizioterapeuti i lartë dhe trajneri i aktiviteteve psike-motorike të dy nga Handicap International.

Duhet theksuar se kontribut të jashtëzakonshëm në përkrahjen e realizimit të programit të HandiKOS-it kanë ofruar partneret ndërkombëtar si: “Handicap International”, “OXFAM”, Agjencioni Finlandez FIDIDA, Qeveria e Finlandës dhe Ambasada e Finlandës, Organizata Italiane “Onlus Wamba-Athena”, “Onlus Roberto Bazzoni”, “Save The Children”, “UNICEF”, Agjencioni Evropian për ndërtim dhe rindërtim, etj., ndërsa nga viti 2004 HandiKOS-in në mënyrë modeste e kanë përkrahur edhe disa Komuna të Kosovës dhe donator lokal.

Gjatë kësaj periudhe HandiKOS u rrit dhe u zhvillua, sidomos në drejtim të ndërtimit të kapaciteteve, si dhe krijimit të infrastrukturës, në ndërtimin e objekteve në shumicën e komunave të Kosovës, si në: Suharekë, Pejë, Drenas, Malishevë, Dragash, Ferizaj, Mitrovicë, Mitrovicë Veriore, Lipjan, Shtime, Istog, Gjilan, Prizren, etj, e sidomos duhet përmendur ndërtimin e Qendrës Resurseve të Personave me Aftësi të Kufizuara, mbështetur nga “WINSLOW STARK FOUNDATION” dhe “LINDEN ROOT DICKINSON FOUNDATION” dhe implementuar nga “World Vision”. Të gjitha këto objekte janë të pajisura me të gjitha pajisjet e nevojshme të punës për të ofruar shërbime rehabilituese primare fizikale dhe psiko-sociale, mjete transporti, dhe pajisje zyre.

### *Disa nga rezultatet e arritura nga kjo punë disa vjeçare përfshijnë*

- Aktualisht HandiKOS veprimtarinë e vet e zhvillon në tërë territorin e Republikës së Kosovës me 13 Zyra lokale dhe 14 Qendra të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, përfshirë këtu edhe pjesën Veriore të Kosovës;
- HandiKOS ka një databazë me 18,000 anëtarë me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara të moshave, gjinive dhe etnive të ndryshme;
- Nga viti 1999 deri më sot HandiKOS ka ofruar shërbime të rehabilitimit primar për rreth 2,900 fëmijë me aftësi të kufizuara duke ju ofruar rreth 22,500 trajtime të rehabilitimit psiko-sociale dhe primar fizikal të ofruara në çdo vit;
- HandiKOS ka ofruar rreth 6,300 pajisje të ndryshme ndihmëse, përfshirë këtu karrocet, kukëzat, karroca tualeti, material për inkontinencë, material për trajtimin e plagëve dekubitare etj.;



## Historiku i HandiKOS

- Në mbështetje të organizatave ndërkombëtare, HandiKOS ka arritur që të përmirësoj qasjen në infrastrukturën fizike duke rregulluar 96 pjerrina në objektet publike si dhe adaptimin e ambienteve të banimit tek personat me aftësi të kufizuara.
- 1,550 fëmijë dhe të rritur nga e gjithë Kosova kanë përfituar nga rehabilitimi i ofruar gjatë kampeve aktive në bregdet;
- HandiKOS ka avokuar, lobuar dhe ka marre pjese në krijimin, ndryshimin dhe monitorimin e implementimit të infrastrukturës ligjore në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;
  - Përmes organizimit të fushatave të ndryshme, dokumentarëve, videoprezantimeve, debateve televizive, tryezave, HandiKOS ka ngritur vetëdijen e personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve për të drejtat e tyre, përfaqësuesve të institucioneve dhe mbarë shoqërisë në Kosovë;
  - HandiKOS ka publikuar udhëzues dhe doracak të ndryshëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, duke u bërë burimi i vetëm i informacionit mbi aftësinë e kufizuar në Kosovë;
  - HandiKOS gjatë gjithë këtyre viteve ka ngritur kapacitetet e stafit në harmoni me nevojat e personave me aftësi të kufizuara duke ju përshtatur rrethanave të kohës;
  - HandiKOS është një nga organizatat e cila punëson më së shumti persona me aftësi të kufizuar dhe ndërmjetëson punësimin e tyre në tregun e punës duke ngritur kapacitetet e tyre;
  - Gjate kësaj kohe HandiKOS zhvilloi kapacitetet dhe u bë partner serioz i donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare dhe lokale në implementimin e projekteve, si dhe forcoj bashkëpunimin me institucione të nivelit qendror dhe lokal me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe avancimit të pozitës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Analiza e situatës

## Analiza e situatës

Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar e adaptuar në vitin 2006, ka si qëllim “të nxisë, mbrojtë dhe të siguroj që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre<sup>1</sup>.”

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në Raportin Botëror mbi aftësinë e kufizuar<sup>2</sup> (2011) përllogarit se janë rreth një miliardë persona, ose 15% e popullsisë së botës, të cilët kanë së paku një formë të aftësisë së kufizuar. Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, aftësia e kufizuar në Kosovë prek rreth 77,730 persona<sup>3</sup>, që do të thotë 4.4% e popullsisë. Nëse e krahasojmë me shifrat e paraqitura nga OBSH, popullsia e prekur nga së paku një formë e aftësisë së kufizuar në Kosovë duhet të arrij shifrat e 260,000 persona. Kjo paraqet dhe një mungesë të të dhënave sasiore dhe cilësore për persona me aftësi të kufizuar, shifër e cila do të informonte politika që adresojnë numrin dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuar.

Në vitin 2006 Kryeministri i Kosovës me vendim ka themeluar Këshillin Nacional të Aftësisë së Kufizuar, me qëllim krijimin e mundësive të barabarta, përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara në fushë e arsimit, punësimin, shërbimet ndihmëse dhe jetesës pa pengesa<sup>4</sup>. Ky këshill përbëhej nga Zv. Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Zyra për Qeverisje të Mirë, Zv. Ministri i MPMS, Zv. Ministri i MASHT-it, Zv. Ministri i MPL, Zv. Ministri i Shëndetësisë, Zv. Ministri i MTPTK, dhe përfaqësues të komunitetit të personave me aftësi të kufizuar dhe të shoqërisë civile. Edhe pse i themeluar dhe shumë i rëndësishëm, ky këshill ka arritur pak rezultate. Ndërsa për të njëjtin qëllim, në vitin 2011, Kryeministri i Kosovës ka nxjerr një vendim të ri për themelimin dhe funksionimin e Këshillit Nacional të Aftësisë së Kufizuar, i cili deri më tani ka organizuar vetëm një takim. Në kuadër të Njësive për të Drejtat e Njeriut në shumicën e Ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovë veprojnë zyrtarët për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Zyra për Qeverisje të Mirë është bartëse e hartimit të Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, si dhe Planit të Veprimit 2013-2016 e para e këtij lloji në Kosovë, e cila së bashku me organizatat e personave me aftësi të kufizuara do të monitoroj implementimin e këtyre dy dokumenteve.

Institucionet publike në Kosove deri më tani nuk kanë marrë gjithmonë në konsideratë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, duke mos i adresuar ato në ligjet dhe prioritetet shtetërore. E megjithatë disa ligje dhe udhëzime

<sup>1</sup>[http://www.adrf.org.al/images/konventa\\_shqip.pdf](http://www.adrf.org.al/images/konventa_shqip.pdf)

<sup>2</sup>[http://whqlibdoc.who.int/hq/2011/WHO\\_NM\\_H\\_VIP\\_11.01\\_eng.pdf](http://whqlibdoc.who.int/hq/2011/WHO_NM_H_VIP_11.01_eng.pdf)

<sup>3</sup><http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Living-condition-ALB.pdf>

<sup>4</sup><http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,90>

## Analiza e situatës

administrative garantojnë disa nga të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë. Ligjet më të rëndësishme të dedikuara në mënyrë të drejtpërdrejtë personave me aftësi të kufizuar janë:

- Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, Nr. 2003/23;
- Ligji për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, Nr.03/L-022;
- Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Nr. 03/L-019;
- Ligji për personat e verbër Nr. 04/L-092;
- Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032
- Ligji për paraplegjikët dhe tetraplegjikët (në programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2013)<sup>5</sup>

Ligjet që përmbajnë provizione relevante lidhur me personat me aftësi të kufizuar janë:

- Ligji i Punës, Nr. 03/L-212;
- Ligji mbi Ndërtimin, Nr. 04/L-110;
- Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3;
- Ligji për Skemën e Asistencës Sociale, Nr. 2003/15

*Për më tepër ka edhe tre akte legjislative të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuar:*

- Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 07/2007;
- Udhëzimi Administrativ për menaxhimin e materialit të inkontinencës urinare për personat me aftësi të kufizuara Nr. 03/2012;
- Vendimi për gjuhën e shenjave Nr. 06/146.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Social përmes skemës së mbështetjes materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme 1-18 vjeç, mbështet 2,985 familje me 100 Euro në muaj, dhe përmes skemës së pensionit për personat me aftësi të kufizuar prej 18-65 vjeç rreth 17,000 persona me 60 Euro në muaj<sup>6</sup>. Gjithashtu, duhet përmendur se kjo ministri rezulton të mos ketë të dhëna mbi personat me aftësi të kufizuar të punësuar në Kosovë, edhe pse kjo është një nga nevojat kryesore të tyre.

Ministria e Shëndetësisë, përmes institucioneve shëndetësore, ofron vetëm mjekimet shëndetësore bazë, dhe nuk

<sup>5</sup>[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI\\_LEGJISLATIV\\_PER\\_VITIN\\_2013\\_-\\_LEGISLATIVE\\_PROGRAM\\_2013\\_-\\_ZAKONODAVNI\\_PROGRAM\\_2013\\_mars.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_LEGJISLATIV_PER_VITIN_2013_-_LEGISLATIVE_PROGRAM_2013_-_ZAKONODAVNI_PROGRAM_2013_mars.pdf)

<sup>6</sup>Të dhëna nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Maj 2013.

## Analiza e situatës

mbulon shërbimet dhe medikamentet specifike të cilat janë më se të nevojshme në trajtimin e pasojave që shkaktohen nga aftësia e kufizuar. Këto akoma nuk janë të rregulluara përmes një ligji të veçantë. Rehabilitimi shëndetësor, monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes shëndetësore, dhe pajisja me medikamentet e nevojshme janë disa nga shërbimet të cilat do të përmirësonin gjendjen shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara dhe do të lehtësonin pasojat e tyre. Gjithashtu, stafi mjekësor ka nivel të ulët të informacionit mbi llojet e aftësive të kufizuara, prejardhjen dhe pasojat që secila shkakton tek personat, kjo e fundit duke rezultuar shpeshherë në një qasje joadekuate tek pacientët duke ia atribuar çdo lloj sëmundjeje aftësisë së kufizuar.

Disa nga shkaktarët e integritit të ulët të personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor janë mungesa e qasjes fizike në institucionet arsimore, mungesa e pedagogëve të trajnuar, mungesa e asistentëve personal etj. Ministria e Arsimit deklaron që 505 shkolla<sup>7</sup> kanë qasje të plotë për fëmijë me aftësi të kufizuara, e megjithatë, i njëjti burim tregon se vetëm 11% e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë integruara në sistemin e ulët arsimor, prej të cilëve 109 persona janë në sistemin parashkollor, 958 persona në sistemin e mesëm të ulët, dhe 154 në sistemin e mesëm të lartë<sup>8</sup>. Gjithashtu, Ministria deklaron se vetëm 25 ekspertë të edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore kanë kryer trajnime për zhvillimin profesional në arsimin gjithëpërfshirës.

Në Kosovë vazhdon të ketë një mungesë të thellë të qasjes në institucione publike, përfshirë këtu institucionet arsimore, shëndetësore, gjykata, prokurori, polici, rrugë etj. e cila i pengon personat me aftësi të kufizuara të jenë pjesëmarrës aktiv në shoqëri. Edhe pse ligji për ndërtim garanton standarde minimale të ndërtimit, ku qasja për persona me aftësi të kufizuara rregullohet përmes udhëzimit administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, këto nuk kanë gjetur akoma zbatim.

Një nga çështjet e rëndësishme në Kosovë vazhdon të jetë niveli i ulët i vetëdijes mbi aftësinë e kufizuar tek personat me aftësi të kufizuar, familjet e tyre, institucionet dhe shoqëria në përgjithësi. Deri më tani, HandiKOS ka qenë një nga burimet kryesore të informimit mbi aftësinë e kufizuar, përmes fushatave vetëdijësuese, avokimit dhe lobimit në institucione të nivelit lokal dhe qendror, broshurave informuese për prindërit dhe për personat me aftësi të kufizuar.

<sup>7</sup>Republika e Kosovës - Qeveria - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Të dhënat për hapësirat/ ndërtesat shkollore në Republikën e Kosovës, lista e institucioneve me qasje për persona me nevoja të veçanta.

<sup>8</sup>Republika e Kosovës - Qeveria - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shënime statistikore 2012-2013, Nxënës në shkolla speciale, klasa të bashkangjitura dhe të mbështetura.

### Analiza SWOT (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet)

HandiKOS ka një shtrirje të gjerë në të gjithë Kosovën përmes qendrave të rehabilitimit të bazuar në bashkësi në 14 komuna dhe 12 zyra lokale. Me tridhjetë vjet eksperiencë, HandiKOS është e vetmja qendër e cila ofron me profesionalizëm shërbime cilësore dhe mjete ndihmëse sipas nevojës për persona me aftësi të kufizuara në vend.

Gjatë kësaj eksperiencë të gjatë, dhe me asistencën dhe mbështetjen e shumë donatorëve dhe partnerëve vendas dhe të huaj, HandiKOS ka arritur të krijoj një besueshmëri të lartë tek më shumë se 18,000 anëtarët e saj, familjarët e tyre, institucionet dhe shoqëria, dhe ka ofruar shërbime të rehabilitimit primar për 2200 fëmijë. HandiKOS vazhdon të jetë një nga të vetmet institucione në Kosovë, puna e të cilës informohet nga personat me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara, duke avokuar dhe lobuar për përmbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Edhe pse HandiKOS ka ofruar dhe vazhdon të ofroj shërbime primare rehabilituese për persona me aftësi të kufizuara, këto nuk mjaftojnë. Qendrat e rehabilitimit të bazuar në bashkësi në vitet e fundit po vuajnë nga mungesa e mbështetjes financiare nga donatorët e huaj dhe nga institucionet shtetërore, edhe pse kjo e fundit është e garantuar me ligj. Kjo e fundit është bërë shkak për shkurtimin e burimeve njerëzore të cilët kanë ofruar shërbime me profesionalizëm për një kohë të gjatë në HandiKOS. Kjo situatë kërkon angazhim më të lartë në avokim dhe lobim për financimin e shërbimeve nga institucione lokale. Gjithashtu qendrat duhet të shikojnë mundësinë për të krijuar shërbime të cilat reflektojnë nevojat e grupeve të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Përpos të lartpërmendurave, HandiKOS ka mungesë të paraqitjes në formë të shkruar të punës së kryer deri më tani e cila do të lehtësonte avokimin dhe lobimin për ngritje të fondeve.

Mungesa e fondeve për ofrimin e shërbimeve po ndikon edhe në zbehjen e imazhit të HandiKOS si një nga organizatat e vetme të cilat ofrojnë shërbime për persona me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër organizata të reja kanë filluar të ofrojnë shërbime, gjë e cila e rrit edhe konkurrencën për financim të shërbimeve të HandiKOS. Rritja e numrit të organizatave apo kompanive të cilat i ofrojnë këto shërbime mund të ndikoj edhe në mos interesimin e personave në shërbimet e ofruara nga HandiKOS, gjendja e të cilave është duke u përkeqësuar çdo ditë e më tepër.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka filluar procesin e licencimit të punonjësve social dhe organizatave të

**Analiza SWOT (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet)**

cilat ofrojnë shërbime sociale. Qendrat e rehabilitimit të bazuar në bashkësi të HandiKOS, kanë mundësinë të zhvillojnë ide të reja të shërbimeve sociale të cilat mund të financohen nga Komunitet e Kosovës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjithashtu, qendrat e HandiKOS-it, përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të eksperiencave mes organizatave vendase dhe të huaja, mund të zhvillojnë ide të reja në ofrim të shërbimeve dhe mbledhjeve të fondeve, përfshirë këtu edhe aktivitete të gjenerimit të të ardhurave. Duke marrë parasysh situatën e tanishme, HandiKOS ka nevojë të riorganizoj strukturën administrative të saj, në mënyrë që ti përgjigjet ndryshimeve në financime dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

### Analiza e akterëve

HandiKOS bashkëpunon me një sërë akterësh vendor dhe ndërkombëtar të cilët janë të domosdoshëm në njohjen dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara, pa kontributin e të cilëve HandiKOS nuk do të mund ti realizoj qëllimet e veta.

HandiKOS do të bashkëpunoj me institucionet në nivel qendror dhe ato lokal përfshirë këtu: Kuvendin e Kosovës, Komisionet Parlamentare, Zyrën e Kryeministrit, Ministritë, zyrtarët për të drejta të njeriut, Avokatin e Popullit, drejtoritë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në të gjithë komunat e vendit, shoqërinë civile etj. Personat me aftësi të kufizuar, familjet e tyre dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuar do të jenë bashkëpunëtorët kryesor të cilët do të mbështesin në implementimin e strategjisë së HandiKOS-it. Sektori privat dhe bizneset e ndryshme do të jenë grupi tjetër i bashkëpunëtorëve të cilët do të lehtësojnë integrimin në punësim të personave me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, HandiKOS do të bashkëpunoj me agjencionet dhe organizatat ndërkombëtare si Organizata Botërore e Shëndetësisë, UNICEF, UNDP, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuar, Save the Children, si dhe përfaqësuesit e organizmave dhe institucioneve ndërkombëtare në Kosovë.

**Misioni i HandiKOS, Vizioni i HandiKOS, Objektivat Strategjike 2014 – 2016****Misioni i HandiKOS**

HandiKOS, organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1983, përfaqëson dhe përkrah personat me aftësi të kufizuar duke avokuar dhe lobuar dhe duke ofruar shërbime përmes rrjetit të shtrirë në të gjithë Kosovën për të arritur të drejta të barabarta, një jetë të pavarur dhe të dinjitetshme për të gjithë.

**Vizioni i HandiKOS**

Shoqëri gjithëpërfshirëse me njohje dhe respektim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara.

**Objektivat Strategjike 2014 – 2016**

Objektiva strategjike 1: Avancimi i të drejtës për lëvizje të lirë, shërbime cilësore shëndetësore, mirëqenie sociale, arsim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara

1.1: Mobilizimi i personave me aftësi të kufizuar në të gjitha komunitetet e Kosovës

1.2: Pjesëmarrja dhe avokimi për krijimin dhe monitorimin e implementimit të legjislacionit për personat me aftësitë e kufizuar

1.3: Ngritja e vetëdijes për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara tek institucionet dhe shoqëria

Objektiva strategjike 2: Zhvillimi dhe avancimi i shërbimeve sociale të vetë qëndrueshme të bazuara në bashkësi për persona me aftësi të kufizuar

2.1: Riorganizimi strukturor i qendrave dhe zyrave lokale të HandiKOS-it duke ju përmbajtur ndryshimeve për ofrim të shërbimeve sociale

2.2: Licencimi i HandiKOS dhe i stafit për ofrim të shërbimeve social dhe ofrimi i shërbimeve cilësore

2.3: Ngritja e kapaciteteve dhe profesionalizmit të stafit sipas standardeve për shërbimet e ofruara



## Realizimi i objektivave strategjike

### ***Objektiva Strategjike1: Avancimi i të drejtës për lëvizje të lirë, shërbime cilësore shëndetësore, mirëqenie sociale, arsim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara***

HandiKOS duke u mbështetur në parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventës Ndërkombëtarë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe në parimet e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023, do të punoj drejt avancimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Kjo objektivë strategjike i dedikohet rrjetëzimit dhe fuqizimit të personave me aftësi të kufizuar, përmes Qendrave dhe zyrave lokale, të cilat do të avokojnë dhe llobojnë në zhvillimin dhe implementimi e një kornize legjislative në përputhje me nevojat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Për të arritur avancimin e të drejtave, HandiKOS do të punojë shumë në mobilizimin dhe fuqizimin e vetë personave me aftësi të kufizuara. Kjo do të arrihet përmes organizimit të kuvendeve lokale të cilat avokojnë dhe llobojnë sipas fushave të caktuara, ku rëndësi e veçantë do t'ju jepet edhe takimeve me anëtarët e HandiKOS. Këto kuvende gjithashtu do të monitorojnë punën e HandiKOS-it duke siguruar që puna e saj është në harmoni me nevojat e tyre. Gjithashtu, kuvendet lokale do të përzgjedhin përfaqësues për Kuvendin e Përgjithshëm të Anëtarëve të HandiKOS-it të cilët do të asistojnë në krijimin dhe forcimin e rrjetit të organizatave të personave me aftësi të kufizuar dhe do të monitorojnë zbatimin e kësaj strategjie.

Me rrjet të fuqizuar, HandiKOS, do të punoj drejt krijimit të një legjislacioni adekuat për persona me aftësi të kufizuar. Po ashtu do të monitoroj implementimin e legjislacionit dhe strategjive përkatëse, do të marrë pjesë në hartimin dhe zhvillimin e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik si dhe do të ndikoj në ndryshimin e ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar dhe inicij ligjin për asistent personal. HandiKOS do të bashkëpunoj ngushtë me organizata vendore dhe ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuar në themelimin dhe funksionalizimin e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, i cili do të jetë një zë i përbashkët në avokim dhe lobim për arritjen e kësaj objektivë strategjike. Për të arritur shërbimet cilësore shëndetësore, HandiKOS do të punoj edhe me institucionet shëndetësore për themelimin e njësisë spinale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Një nga sfidat kryesore në përmbushjen e të drejtave, është niveli i ulët i vetëdijes për të drejta e personave me aftësi të kufizuar nga përfaqësuesit e institucioneve, familjet e tyre, shoqëria në përgjithësi si dhe nga vete personat

## Realizimi i objektivave strategjike

aftësi të kufizuar. Kjo objektivë strategjike i dedikohet rrijtimit dhe fuqizimit të personave me aftësi të kufizuar, përmes Qendrave dhe zyrave lokale, të cilat do të avokojnë dhe llojnë në zhvillimin dhe implementimi e një kornize legjislative në përputhje me nevojat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

### ***Objektiva strategjike 2: Zhvillimi dhe avancimi i shërbimeve sociale të vetë qëndrueshme të bazuara në bashkësi për personat me aftësi të kufizuara***

Në harmoni të plotë me procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale, si dhe me licencimin e organizatave ofruese të shërbimeve sociale, HandiKOS do të punoj drejt krijimit të shërbimeve të vetë qëndrueshme të cilat përkohë me nevojat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë. Kjo objektivë strategjike i dedikohet forcimit dhe ristrukturimit të qendrave dhe zyrave lokale të HandiKOS-it, arritjes së kontraktimit të shërbimeve nga institucione të nivelit lokal dhe qendror, si dhe ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të stafit.

Në realizimin e ristrukturimit të qendrave dhe zyrave si dhe arritjes së kontraktimit të shërbimeve, HandiKOS do të përcaktoj kritere bazë të funksionimit, të cilat duhet t'i përmbushin përpara se të arrihet ristrukturimi. Secila nga qendrat dhe zyrat lokale do të përkrahët në këtë proces përmes organizimit të trajnimeve sipas nevojave, zhvillimit të strategjive për ngritje të fondeve, organizimin e aktiviteteve për gjenerim të të ardhurave si dhe çështje të tjera. Qendrat do të monitorohen për të siguruar që puna e tyre është në përputhje me këtë strategji.

Pasi secila qendër të vendos për llojin e shërbimeve që do të ofrohen për personat me aftësi të kufizuar, ato do të punojnë në plotësimin e kritereve si dhe marrjen e licencës si ofrues të shërbimeve sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Qendrat dhe Zyrat Lokale së bashku me persona me aftësi të kufizuara do të organizojë takime të rregullta dhe të koordinuara me institucionet përkatëse si Asociacionin e Komunave të Kosovës, Kuvendet Komunale, përfaqësues të tjerë të institucioneve në nivel qendror dhe lokal si dhe organizatat e shoqërisë civile.

Për të arritur këto, HandiKOS do të rris kapacitetet dhe profesionalizmin e stafit në harmoni me nevojat e secilës qendër dhe llojit të shërbimeve që do të ofrohen. HandiKOS do të organizoj trajnime të ndryshme dhe vizita studiuuese për stafin e qendrave si dhe për personat me aftësi të kufizuar të cilët janë edhe pjesëmarrës në kuvendet lokale.

## Plani i Punës

**Objektivat Strategjike 1: Avancimi i të drejtës së lëvizjes së lirë, shërbime shëndetësore cilësore, mirëqenie sociale, arsim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara**

**Nën objektivat 1.1: Mobilizimi i personave me aftësi të kufizuara në të gjitha Komunat e Kosovës**

Aktivitetet	Afati	Pala përgjegjëse
1.1.1. Krijimi i grupit koordinues dhe përkrahës për themelimin e Kuvendeve Lokale	Janar 2014	Niveli qendror i HandiKOS-it
1.1.2. Themelimi i Kuvendeve Lokale	Shkurt – Mars 2014	Menaxherët/përgjegjësit e Zyrave, Grupi koordinues
1.1.3. Themelimi i grupeve brenda kuvendeve për lobim, avokim, këshillim, mbështetje etj.	Mars-Maj 2014	Menaxherët/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale
1.1.4. Përzgjedhja e përfaqësuesve dhe themelimi i Kuvendit të ri të Anëtareve	Maj – Qershor 2014	Niveli qendror i HandiKOS-it Kuvendet Lokale
1.1.5. Mbajtja e takimeve të rregullta të Kuvendit Qendror të anëtareve	2014-2016	Kuvendi i Anëtareve, niveli qendror i HandiKOS-it

**Nën objektivat 1.2: Pjesëmarrja dhe avokimi për krijimin dhe monitorimin e implementimit të legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara**

Aktivitetet	Afati	Pala përgjegjëse
1.2.1. Monitorimi i zbatimit të ligjeve ekzistuese	Janar 2014 Dhjetor 2016	Niveli qendror i HandiKOS-it, Menaxheret/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale
1.2.2. Pjesëmarrja në hartimin e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik	Qershor-Nëntor 2014	Përfaqësuesit e HandiKOS-it në ekipin punues
1.2.3. Inicimi dhe ndikimi për ndryshimin e ligjit të pensioneve të aftësisë së kufizuara	Janar-dhjetor 2014	Niveli qendror i HandiKOS-it
1.2.4. Inicimi i ligjit për asistent personal	Qershor 2014 Qershor 2015	Niveli qendror i HandiKOS-it

### Plani i Punës

1.2.5.Ndikim dhe pjesëmarrje në inicimin, hartimin dhe ndryshimin e ligjeve për Personat me Aftësi të Kufizuara	Janar 2014- Dhjetor 2016	Niveli qendror i HandiKOS-it
1.2.6.Bashkëpunimi me OPAK në krijimin e forumit kosovar të aftësisë së kufizuar	Janar-Dhjetor 2014	Niveli qendror i HandiKOS-it
1.2.7.Monitorimi i zbatimit të strategjisë nacionale 2013-2023 dhe planit të veprimit për aftësinë e kufizuar 2013-2015.	Janar 2014 -Dhjetor 2016	Niveli qendror i HandiKOS-it, Menaxherët/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale
1.2.8.Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore brenda organizatës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar	Janar 2014-Dhjetor 2016	Niveli qendror i HandiKOS-it, Menaxherët/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale
1.2.9.Krijimi dhe fuqizimi i partneritetit me OPAK ndërkombëtare	Janar 2014- Dhjetor 2016	Niveli qendror i HandiKOS-it
1.2.10.Pjesëmarrje në konferenca dhe forume ndërkombëtare	Janar 2014 -Dhjetor 2016	Niveli qendror i HandiKOS-it
1.2.11. Inicimi i themelimit të njësisë spinale në QKUK	Janar 2014- Dhjetor 2016	Niveli qendror i HandiKOS-it
<b>Nën objektiva 1.3: Ngritja e vetëdijes për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara tek institucionet dhe shoqëria</b>		
<b>Aktivitetet</b>	<b>Afati</b>	<b>Pala përgjegjëse</b>
1.3.1.Organizimi i takimeve me zyrtarët për të drejtat e njeriut	Janar-Mars 2014	Niveli qendror i HandiKOS-it, Menaxherët/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale
1.3.2.Organizimi i evenimenteve për ditën ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar	Nëntor-Dhjetor 2014,2015,2016	Niveli qendror i HandiKOS-it, Menaxherët/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale
1.3.3.Organizimi i ligjëratave për aftësinë e kufizuar në arsimin para dhe universitar	Mars-Maj 2014, 2015, 2016	Niveli Lokal i HandiKOS-it
1.3.4.Organizimi i fushatës për përmirësimin e qasjes fizike "Prishtina për të gjithë"	Shtator - Tetor 2014	Niveli Lokal i HandiKOS-it

### Plani i Punës

1.3.5.Pjesëmarrje në debate dhe takime publike me subjekte politike për zgjedhjet lokale 2013	Shtator - Tetor 2014	Menaxherët/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale
1.3.6.Krijimi i faqes zyrtare ne internet të HandiKOS	Qershor-Tetor 2014	Niveli qendror i HandiKOS-it
1.3.7.Publikimi dhe shpërndarja e “Doracakut për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”	Janar-Shkurt 2014	Niveli qendror i HandiKOS-it
1.3.8.Themelimi i Federatës të Sporteve për persona me aftësi të kufizuara fizike	Mars - Maj 2014	Niveli qendror i HandiKOS-it

**Objektiva Strategjike 2: Zhvillimi dhe avancimi i shërbimeve sociale të vetë qëndrueshme të bazuara në bashkësi për personat me aftësi të kufizuara**

**Nën objektivat 2.1: Riorganizimi strukturor i qendrave dhe zyrave lokale të HandiKOS duke ju përmbajtur ndryshimeve për ofrim të shërbimeve sociale**

Aktivitetet	Afati	Pala përgjegjëse
2.1.1. Përcaktimi i kriterëve për ristrukturimin e qendrave	Janar - Mars 2014	Bordi dhe ekspert të fushës
2.1.2. Përcaktimi i shërbimeve që do të ofrohen në qendrat dhe zyrat	Mars – Maj 2014	Menaxherët/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale
2.1.3.Përkrahja e qendrave në procesin e plotësimit të kriterëve	Maj - Dhjetor 2014	Niveli qendror, Kuvendi Lokal, bordi dhe ekspertët e fushës
2.1.4.Monitorimi i funksionimit të qendrave të ri-strukturuara	Janar-Dhjetor 2015	Niveli qendror, Kuvendet Lokale, bordi dhe ekspert të fushës
2.1.5. Çdo qendër krijon strategji lokale të ngritjes së fondeve	Janar - Prill 2014	Menaxheret/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale, niveli qendror
2.1.6. Zhvillimi i aktiviteteve për gjenerim të të ardhurave	Janar – Korrik 2014	Menaxheret/përgjegjësit e Zyrave, Kuvendet Lokale, niveli qendror

### Plani i Punës

2.1.7. Themelimi i Fondacionit HandiKOS	2014	Niveli qendror
<b>Nën objektivat 2.2: Licencimi i HandiKOS-it dhe stafit dhe kontraktimi i shërbimeve nga institucione të nivelit qendror dhe lokal</b>		
<b>Aktivitetet</b>	<b>Afati</b>	<b>Pala përgjegjëse</b>
2.2.1. Çdo qendër përgatit dokumentacionin e stafit dhe aplikojnë për licencim në ofrim të shërbimeve sociale për persona me aftësi të kufizuar nga MPMS	Janar-Dhjetor 2014	Menaxheret/përgjegjësit e Zyrave, niveli qendror
2.3.2.2. Zhvillohen aktivitete lobuese dhe avokuese në nivel qendror dhe komunal për kontraktim të shërbimeve	Mars – Maj 2014	Menaxheret/përgjegjësit e Zyrave, niveli qendror
2.2.3. Zhvillohen takime/prezantime të koordinuara me asociacionin e komunave	2014-2015	Menaxheret/përgjegjësit e Zyrave, niveli qendror
<b>Nën objektivat 2.3: Ngritja e kapaciteteve dhe profesionalizmit të stafit sipas standardeve për shërbimet e ofruara</b>		
<b>Aktivitetet</b>	<b>Afati</b>	<b>Pala përgjegjëse</b>
2.3.1. Shkëmbimi i përvojave të HandiKOS-it dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare	Mars 2014-Qershor 2016	Niveli qendror dhe niveli lokal i HandiKOS-it
2.3.2. Vlerësimi i kapaciteteve stafit të HandiKOS-it	Janar – Prill 2014	Niveli qendror dhe lokal i HandiKOS-it
2.3.3. Organizimi i trajnimeve për stafin e çdo qendre	Mars – Tetor 2014	Niveli qendror dhe lokal i HandiKOS-it
2.3.4. Organizim/pjesëmarrje në vizita studiu	Prill 2014 Nëntor 2015	Niveli qendror dhe lokal i HandiKOS-it
2.3.5. Trajnimi për personat me lëndime të boshtit kurrizor mbi jetesën	Nëntor 2014	Niveli Qendror i HandiKOS-it

### Resurset e nevojshme

Për të arritur objektivat strategjike, HandiKOS ka nevojë për resurse njerëzore, fizike dhe monetare. Siç edhe është përshkruar më parë, HandiKOS ka ngritur një rrjet prej 14 qendrave dhe 13 zyrave lokale në të gjithë territorin e Kosovës. Qendrat janë të pajisura me të gjitha pajisjet për rehabilitimin psiko-social dhe primar fizikal për fëmijë me aftësi të kufizuara, pajisje zyre, si dhe hapësira për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. Zyrat lokale janë të pajisura me pajisje zyre si dhe hapësira për zhvillimin e aktiviteteve. HandiKOS ka një staf me një eksperience profesionale shumë vjeçare në ofrim të shërbimeve sociale.

Për të arritur këto qëllim HandiKOS ka nevojë për një mbështetje institucionale e cila do të siguronte ekzistencën e këtij rrjeti dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve sociale.





# Strategy and Work Plan

HandiKOS,  
Association of paraplegics  
and paralyzed children  
of Kosovo

PRISHTINA  
2013

2014 – 2016

## ACKNOWLEDGEMENT

